REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM**

**VENDIM**

Nr.2, datë 12/03/2025

**PËR**

**MIRATIMIN E KËRKESËS "PËR REVOKOMIN E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR" ME NR. SERIE 000066 DHËNË ME VENDIMIN NR.30 DATË 20.09.2023 TË KBU ISHËM "SUBJEKTIT "EHW " SH.P.K".**

Në mbështetje të ligjit nr.29/2024, "Për burimet ujore", nenit 146 gërma "ç", si dhe VKM-së nr.550, datë 15.7.2020 "*Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre*", me propozimin e Agjencisë së Burimeve Ujore dhe, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm,

**VENDOSI :**

1. Miratimin e kërkesës "Për revokimin e lejes për përdorim të burimit ujor" me nr. Serie 000066 dhënë me vendimin nr.30 datë 20.09.2023 të KBU Ishëm subjektit "EHW" shpk, me vendëndodhje, Autostrada Tiranë-Durrës, Njësia Administrative Kashar, Bashkia Tiranë.

2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi .

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

**KRYETARI I KBU ISHËM**

**EMILJAN JANI**